



RREGULLORE E PROGRAMIT
TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMIT
(me kohë të plotë)
BACHELOR NË “HISTORI”

Nëntor, 2020

PËRMBAJTJA

KREU I: DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1: Baza ligjore

Neni 2: Misioni dhe objektivat

KREU II: ORGANIZIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Neni 3: Programi i studimit

Neni 4: Pranimi i studentëve në Programin e Ciklit të Parë të studimeve Bachelor në “Histori”

Neni 5: Ndërprerja e studimeve

Neni 6: Transferimi i studimeve, njohja e krediteve dhe ekuivalentimi i lëndëve

KREU III: RREGULLAT E NDJEKJES NË PROGRAMIN E STUDIMIT DHE PROCEDURAT E DIPLOMIMIT

Neni 7: Frekuentimi dhe shlyerja e detyrimeve të lëndëve

Neni 8: Rregullat e zhvillimit të provimeve dhe vlerësimi i lëndës

Neni 9: Sistemi i vlerësimit

Neni 10: Administrimi i dokumentacionit të provimeve

Neni 11: Ankimi për rezultatin përfundimtar

Neni 12: Riprovimet

Neni 13: Përmirësimi i notës

Neni 14: Kalimi në vitin pasardhës dhe në mbrojtjen e diplomës të programit studimor

Neni 15: Diplomimi

Neni 16: Procedura e Diplomimit

Neni 17: Procedura e provimit të diplomës

Neni 18: Pajisja me diplomë

Neni 19: Tërheqja e diplomës

KREU IV: TË DREJTAT DHE DETYRIMET E STUDENTËVE

Neni 20: Të drejtat e studentëve

Neni 21: Detyrimet e studentëve

Neni 22: Përgjegjësi të tjera të studentëve

Neni 23: Masat disiplinore për studentët

KREU V: KOMUNIKIMI

Neni 24: Rregullat e sjelljes akademike

Neni 25: Normat etike gjatë komunikimit Personel Akademik – Student

Neni 26: Çështje akademike

Neni 27: Çështje jo akademike

KREU VI: DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 28: Rishikimi dhe përditesimi

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Baza ligjore

Kjo rregullore bazohet në Ligjin Nr. 80/2015 “Per Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimin e MASR, për çeljen e Programeve të Studimit, Statutit (2018), Rregullores (2015) të Universitetit të Tiranës dhe Standardet për akreditimin e Programeve.

Neni 2

Misioni dhe objektivat

- a) Rregullorja synon të krijojë një kuadër të plotë dhe të qartë për programin e ciklit të parë të studimit Bachelor në “Histori”, si dhe të përcaktojë rregulla standarte të përgatitjes dhe organizimit për studentët e këtij cikli.
- b) Kjo rregullore i bashkangjitet Rregullores së Brendshme të Departamentit të Historisë, shtrin efektin e saj mbi të si njësi bazë përgjegjëse për organizimin e Programit të Ciklit të Parë
- c) Bachelor në “Histori”. Ky program studimi ofrohet nga Departamenti i Historisë, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës dhe siguron Diplomë Universitare Bachelor në “Histori”.
- d) Programi bachelor në Histori synon që:
 - Studentët të kenë plotësuar formimin e tyre në fushën e Historisë së Shqipërisë dhe asaj Botërore;
 - Studentët të përfitojnë një sërë njohurish nëpërmjet leksioneve, seminareve por edhe aktiviteteve të shumta ekstra-kurrikulare të ofruara nga Departamenti.
 - Studentët të përfitojnë njohuri mbi përpunimin e informacionit, shkrimin akademik si dhe aftësi të prezantimit të dijeve të tyre në publik.
 - Studentët të jenë të aftë të përzgjedhin, përpunojnë dhe analizojnë ngjarje të ndryshme historike;
 - Tu ofrojë studentëve shqiptarë dhe atyre të hapësirës shqip-folëse, marrjen e ekspertizës më të mirë të profesorëve të Departamentit të Historisë dhe të qendrave më të mira studimore dhe akademike në Shqipëri;
 - Studentët të përgatiten si specialistë të aftë profesionalisht, në gjendje të përgjigjen nivelit bashkëkohor të zhvillimit.
 - Ky program ju ofron studentëve fleksibilitet në njohuritë e përfituara, duke u mundësuar atyre të zhvillojnë interesat e tyre të specializuara në një gamë shumë të gjerë fushash dhe hapësirash, në pothuajse të gjitha pjesët e botës.

Drejtimi Bachelor në “*Histori*” përkushtohet ndaj vlerave thelbësore të universitetit, si angazhimi intelektual, komuniteti, integriteti, inovacioni dhe gjithëpërfshirja

KREU II ORGANIZIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Neni 3 Programi i studimit

Programi i studimit Bachelor në “Histori” siguron Diplomë Universitare Bachelor në “Histori”. Ky program organizohet dhe shprehet përmes grumbullimit të krediteve sipas Sistemit European të Transferimit të Krediteve (ECTS). Për të fituar këtë diplomë nevojiten 180 kredite (ECTS). 60 kredite (ECTS) përfaqësojnë ngarkesën e punës së një viti akademik studimesh.

- a) Viti akademik është njësia kohore bazë e studimeve. Një vit akademik përbëhet nga 2 semestra dhe shtrihet në intervalin 30 javë mësimore, sipas udhëzimeve MASR (30 javë mësim dhe 6-8 javë provime dhe provim formimi. Fillimi dhe përfundimi i vitit akademik përcaktohet me Udhëzim të MASR në çdo fillim viti akademik.
- b) Çdo semestër zgjat 15 javë për mësim dhe mesatarisht 3-4 javë për provime. Organizimi i vitit akademik, datat e fillimit të semestrave dhe sezoni i provimeve, shpallen nga Dekani në fillim të çdo viti akademik. Struktura akademike e çdo viti shpallet në faqen zyrtare të fakultetit
- c) Me fillimin e vitit akademik, Dekanati nëpërmjet faqes ëeb shpall orarin mësimor: ditën, orën, sallën dhe personelin akademik përkatës, për semestrin përkatës.
- d) Në programin e studimit Bachelor në Histori, në përgjithësi lëndët janë semestrare dhe së bashku me kreditet (ECTS) janë të pasqyruara në planin mësimor të miratuar të programit të studimit.
- e) Numri i caktuar i kredive fitohet pas përfundimit me sukses të lëndës, siç është përshkruar në këtë Rregullore dhe në Rregulloren e Brendshme të Universitetit.
- f) Vlerësimi i studentëve bëhet nga personeli akademik përkatës që zhvillon lëndët mësimore, që organizon sipas gjykimit të tij kontrole me gojë, me shkrim, ose i kombinuar me shkrim dhe me gojë, detyra të pavarura, detyra kursi, në përputhje me mënyrat e vlerësimit të përcaktuara në këtë Rregullore dhe në Rregulloren e Brendshme të Universitetit.
- g) Studenti përfundon studimet në këtë program studimi dhe merr diplomë kur ka likuiduar me sukses gjithë disiplinat mësimore të parashikuara në planin mësimor përkatës, provimin e formimit, dhe ka fituar 180 kredite (ECTS).
- h) Kohëzgjatja maksimale e studimeve nuk mund të jetë më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes normale të programit të studimit, pa marrë në konsideratë periudhën kur student i ka pezulluar studimet.
- i) Studenti mund të përfundojë studimet e plota dhe të mbrojë diplomën, brenda afatit të rregullt të studimeve ose tej kufirit që parashikon ky afat duke iu nënshtruar detyrimeve që lindin nga kohëzgjatja e studimeve përtej kohës normale.
- j) Studenti, që nuk arrin të përfundojë studimet brenda kohëzgjatjes maksimale të programit, ka të drejtë të aplikojë për të rifilluar studimet, në të njëjtin program studimi ose në një program tjetër. Ai u nënshtrohet kriterëve dhe procedurave të shpallura për regjistrimin në programin e studimit të institucionit pritës. Kreditet e grumbulluara nga student i gjatë

periudhës së mëparshme të studimeve mund të transferohen, me vendim të njësisë bazë dhe kryesore të institucionit që pranon studentin.

k) .Kohëzgjatja e orës së mësimi është 60 minuta.

Neni 4

Pranimi i studentëve në Programin e Ciklit të Parë të studimeve Bachelor në “Histori”

Pranimi i studentëve në Programin e Ciklit të Parë të studimeve Bachelor në “Histori”, në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës, realizohet bazuar në nenin 74, të Ligjit Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në udhëzimet e përvitshme të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, në vetë kriteret e parashikuara në Rregulloren e UT si dhe në kriteret dhe kuotat e propozuara nga njësitë bazë dhe të miratuara nga SA i Universitetit të Tiranës.

Neni 5

Ndërprerja e studimeve

Studenti mund të ndërpresë studimet në çdo kohë të vitit vetëm për këto raste:

- a. Kur sëmuret për periudha të gjata, të dokumentuara me raport komisioni mjekoligjor;
- b. Në raste fatkeqësish familjare e në kushte ekonomike të vështira, të dokumentuara këto nga zyrat përkatëse të pushtetit lokal
- c. Në rastet kur studenti ndjek studime e kualifikime në institucione të tjera të arsimit të lartë vendas ose të huaj

Në çdo rast dokumentat duhet të paraqiten përpara se të ndërpresë studimet, të shoqëruara me një kërkesë drejtuar drejtuesit të njësisë kryesore.

Pezullimi i afatit të studimeve deri në 3 (tre) vjet bëhet me miratim të Dekanit. Pezullimi i afatit të studimeve mbi 3 (tre) vjet bëhet me miratim të Rektorit.

Pezullimi i afatit studimeve, fillon nga dita e nesërme e miratimit të pezullimit nga drejtuesi i njësisë kryesore ose Rektori. Në rast të kundërt, studenti mban vetë përgjegjësi për pasojat.

Midis studentit dhe Dekanit ose Rektorit, nënshkruhet një marrëveshje për afatin e ndërprerjes së studimeve. Rikthimi i studentit, pas ndërprerjes së justifikuar të studimeve bëhet në fillim të çdo semestri, por jo më vonë se një muaj nga këto afate.

Studentit që ka ndërprerë studimet, i njihen të gjitha detyrimet e shlyera në vitin që është shkëputur. Ai i nënshtrohet detyrimeve të programit mësimor që gjen pas rifillimit të studimeve.

Studentët të cilët ndërpresin studimet për dy ose më shumë semestra radhë dhe nuk kanë marrë lejen nga dekani apo rektori për këtë ndërprerje duhet të aplikojnë përsëri për ripranim në universitet mbështetur në rregulloren e Universitetit të Tiranës.

Ndërprerja e studimeve, me miratimin e organit përkatës, quhet e justifikuar dhe nuk llogaritet në vitet e përsëritura.

Çdo ndërprerje e pajustificuar dhe e pa merituar është e barsvlerëshme me mosparaqitjen në procesin mësimor dhe viti konsiderohet si vit përsëritjeje.

Neni 6

Transferimi i studimeve, njohja e krediteve dhe ekuivalentimi i lëndëve

Është e mundur njohja e plotë dhe e pjesshme e krediteve të studentëve që vijnë me transferim nga programe të tjera studimi brenda ose jashtë universitetit. Pranë Departamentit ngrihet Komisioni Ad-hoc i cili vlerëson kërkesën dhe dokumentacionin e nevojshëm e përcjellë nga Sekretaria Mësimore, sipas përcaktimeve në rregulloren e Universitetit të Tiranës dhe bën njohjen e krediteve përkatëse për disipinat mësimore të likuiduara. Modalitetet dhe procedurat për transferimin e studentëve janë të përcaktuara në Nenin 78-82 të Rregullores së Universitetit.

KREU III

RREGULLAT E NDJEKJES NË PROGRAMIN E STUDIMIT DHE PROÇEDURAT E DIPLOMIMIT

Neni 7

Frekuentimi dhe shlyerja e detyrimeve të lëndëve

- a. Frekuentimi i leksioneve është fakultativ, frekuentimi i i seminareve është i detyruar në masën 75%.
- b. Frekuentimi i punëve laboratorike, praktikave profesionale apo kryerja e ushtrimeve, detyrave të kursit, është i detyruar në masën 100%. Kur studenti nuk ka ndjekur deri në 25% të punëve laboratorike të çdo lënde, i shlyen ato në dy javët e fundit të vitit në vazhdim, apo semestrit kur lënda është semestrale. Nëse nuk ka ndjekur më shumë se 25% të tyre, i shlyen ato në vitin pasardhës.
- c. Projektet e kursit janë të detyruara të shlyhen në masën 100%, në të kundërt, studenti nuk hyn në provimin e lëndës.
- d. Çdo pedagog është i pajisur me regjistrin përkatës i cili përmban informacion mbi veprimtarinë e mësimdhënies dhe frekuentimit. Pedagogu përgjigjet drejtpërdrejt për saktësinë e informacionit mbi frekuentimin.
- e. Studentët e ciklit të parë të studimeve regjistrohen në lëndët që ofrohen në atë sezon sipas planit mësimor të sugjeruar, në të cilat nuk është regjistruar asnjëherë më parë.
- f. Në rast se studenti mungon gjatë zhvillimit të kursit dhe tejkalon numrin total të mungesave të lejuara për gjithë semestrin (jo më pak se 75 % frekuentim), atëherë studenti skualifikohet për shkak të mungesave, nuk futet në provimin e radhës, në procesverbalin e vlerësimit shënohet "Detyrim Akademik". Kur studenti ka ndjekur 50-75% nuk lejohet të futet në provimin e radhës, por kalon në sezonin e rregullt pasardhës. Kur studenti ka ndjekur më pak se 50%, ai frekuenton sërish atë lëndë në vitin pasardhës.
- g. Nëse studenti ka frekuentuar lëndën por nuk paraqitet në provimin e radhës, në procesverbalin e vlerësimit shënohet "Nuk u paraqit". Studentët nuk kanë detyrimin dhe nuk mund të regjistrohen në këto lëndë për të ndjekur lëndën si përsëritës, por kanë të drejtën të shlyejnë lëndën vetëm me provim, sipas përcaktimeve në këtë rregullore.

Neni 8

Rregullat e zhvillimit të provimeve dhe vlerësimi i lëndës

Bazuar në nenet 45-49 të Rregullores së Universitetit të Tiranës.

- a. Kontrolli i dijeve në këtë program studimi në ciklin e parë realizohet përgjatë semestrit

- nëpërmjet një provimi final gjithëpërfshirës si dhe formave të tjera të vlerësimit (detyrë kursi, vlerësim në seminare etj), nëse janë parashikuar në syllabus-in e lëndës.
- b. Provimi, është forma kryesore për vlerësimin përfundimtar të njohurive të lëndëve. Kontrolli i dijes së një lënde me provim përcaktohet nga titullari i lëndës dhe bëhet me shkrim, ose i kombinuar me shkrim e me gojë, duke u mbështetur në programin mësimor.
 - c. Studenti përfiton të drejtën për t'u paraqitur në provimin e një lënde, kur ka shlyer të gjitha detyrimet e parashikuara në planin mësimor dhe në këtë rregullore dhe shlyerja e detyrimeve është e evidentuar nga pedagogu përgjegjës.
 - d. Provimet dhe riprovimet zhvillohen sipas afateve të caktuara në strukturën e vitit akademik, të miratuar nga Dekanati dhe kalendarit të provimeve që shpallet në fillim të vitit akademik. Afatet e përcaktuara për provimet dhe riprovimet janë të detyrueshme për zbatim si për pedagogët, ashtu dhe për studentët. Studenti nuk lejohet të hyjë për të dytën herë në provimin e një lënde brenda një sezoni, përfshirë këtu edhe sezonin e veçantë pasardhës.
 - e. Rregulla apo specifika të provimeve, pesha (përqindja) e provimit, detyrave, laboreve në vlerësimin përfundimtar, literatura, referencat e konvertimit të pikëve në notë etj., përcaktohen në syllabus-in e lëndës të hartuar nga pedagogu dhe u bëhen te ditura studentëve që ndjekin atë kurs.
 - f. Në rastin kur studentin nuk merr pjesë në një provim, por paraqet dokumentacion ku justifikon arsye të forta si probleme shëndetësore serioze (psh. shtrim në spital, aksident të rëndë), raste të jashtëzakonshme fatkeqësish familjare, apo raste urgjencash publike, vendimin për një mundësi tjetër për dhënien e provimit e merr Dekani, duke u bazuar në kërkesën me shkrim të paraqitur nga studentin. Dekani ka të drejtë të kërkojë dokumentacion shtesë për të verifikuar mungesën.
 - g. Kurset janë të gjitha semestrale. Nëse studentin nuk kualifikohet për arsye të mosfrekuentimit, ai ka të drejtën dhe detyrimin ta frekuentojë përsëri atë kurs, në semestrin pasardhës kur kursi ofrohet. Nëse kursi për arsye të ndryshme nuk do të ofrohet më (p.sh për arsye të ndryshmeve në kurrikula), studentin ka të drejtë të frekuentojë atë kurs që mund të ekuivalentojë me kursin që nuk ofrohet më. Krahas kurseve të përcaktuara në planin semestral, studentin ka të drejtë të frekuentojë njëkohësisht edhe kurse të tjera për të cilat ka shënimin mungesë (m) nga semestrin paraardhës, por duke respektuar rregullat e numrit të krediteve të regjistruara në një semestër dhe rregullat e përgjithshme të regjistrimit.
 - h. Teza e provimit hartohet nga titullari i lëndës dhe miratohet nga përgjegjësi i njësisë bazë për programin.
 - i. Me urdhër të përgjegjësit të njësisë bazë, mund të krijohen komisione për mbikëqyrjen e procesit të provimeve. Ndalohet hyrja në provim e personave të jashtëm, me përjashtim të përgjegjësit të njësisë bazë, autoriteteve drejtuese të njësisë kryesore dhe e personave të tjerë të autorizuar me shkrim, nga Dekani ose Rektori për të ushtruar kontroll.
 - j. Studentin paraqitet në provim me një dokument identifikimi. Studentin nuk i lejohet të ketë me vete asnjë material që ka lidhje me provimin, përveç atyre të lejuara nga komisioni i provimit. Në rast shkelje të rregullave të provimit, studentin dërgohet për ndjekje disiplinore, mbështetur në normat e përcaktuara në Statutin e UT dhe këtë Rregullore.
 - k. Në përfundim të provimit me shkrim ose/dhe me gojë, komisioni i provimit, brenda 5 ditëve pune nga data e zhvillimit të provimit, bën shpalljen e rezultateve. Pas ballafaqimit

të studentit me testin e korigjuar në provimin me shkrim dhe me vlerësimin përfundimtar (i cili përfshin rezultatin e vlerësimit të vazhduar dhe rezultatin e provimit përfundimtar), procesverbalet dorëzohen në sekretarinë mësimore brenda 2 ditëve pune nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

- l. Në raste paqartësish, studentët kanë të drejtë të shikojnë personalisht provimin në prani të komisionit të provimit, për të marrë sqarimet e duhura. Për sqarime të mëtejshme ata kanë të drejtë t'i drejtohen me shkrim Pergjegjesit të Departamentit që mbulon kursin përkatës.
- m. Në sezonin e riprovimeve, sekretaritë mësimore hartojnë listat e studentëve që rezultojnë mbartës të lëndëve të ndryshme, si dhe listat e studentëve përsëritës.
- n. Kur studenti në provim vlerësohet me notën 4 (katër) ose "NP" (Nuk u paraqit), ai ka të drejtën të regjistrohet për të shlyer këtë lëndë në sezonin e Vjeshtës dhe në sezonet e veçanta të riprovimeve në Vjeshtë dhe Dimër (në sezonin e veçantë të riprovimeve në dimër mund të shlyejnë detyrimet vetëm për lëndët e semestrit të parë).
- o. Studenti i vlerësuar përsëritës në sezonet e rregullta të provimit ka të drejtë: të rijapë provimin në sezonin e vjeshtës deri në 1/2 e krediteve vjetore (30 kredite), duke përfshirë si lëndët e vitit në vijim, ashtu dhe ato të mbartura nga vite të mëparshme;
Në çdo sesion provimesh Dekanati nëpërmjet faqes zyrtare të fakultetit shpall orarin e provimeve dhe njofton studentët për lëndët ata që kanë të drejtë të japin provim.
- p. Bazuar në Nenin 48 të Rregullores të Universitetit të Tiranës, provimet me shkrim bëhen në fletë të sekretuara. Procedura e sekretimit mban të fshehtë emrin e studentit në fletët e provimit gjatë vlerësimit me notë nga ana e pedagogut.
- q. Në rast të konstatimit të kopjimeve në provime apo detyra kursi studentit i tërhiqet vërejtje me gojë dhe i zerohen pikët e vlerësimit.

Neni 9

Sistemi i vlerësimit

Bazuar në Statutin e Universitetit të Tiranës dhe në Rregulloren e Universitetit të Tiranës, neni 49, shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10. Nota më e ulët kaluese është nota 5 (pesë). Në procesverbalet e vlerësimit përfundimtar për studentin jo kalues (ngelës) vendoset nota 4 (katër). Në të gjitha format e kontrollit të dijes përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht kthehet në notë.

Neni 10

Administrimi i dokumentacionit të provimeve

- a) Në fund të çdo provimi, testet dhe çdo material i provimit ruhen në ambientet e Departamentit të Historisë deri në fund të provimeve të semestrit pasardhës e më pas ato digjen.
- b) Materialet e provimeve të arkivuara në departament, mund të rishikohen dhe të kontrollohen vetëm në rast ankimi ose kur shihet e arsyeshme nga autoritetet drejtuese.

Neni 11

Ankimimi për rezultatin përfundimtar

Bazuar në nenin 50 dhe 51, të Rregullores së Universitetit të Tiranës:

- a) Studenti ka të drejtë të ankohet për procedurën e zhvillimit të provimit. Ankesa i paraqitet me shkrim Përgjegjësit të Departamentit të Historisë brenda 24 orëve nga data e zhvillimit të provimit, i cili bën verifikimet e duhura dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës, vë menjëherë në dijeni Dekanin. Dekani, pasi është njohur me të gjithë procedurën, merr vendim. Nëse ai e gjen të drejtë ankesën e studentit, anulon provimin dhe merr vendim për rizhvillimin e provimit.
- b) Studenti ka të drejtë të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit. Ankesa i paraqitet me shkrim përgjegjësit të departamentit brenda 48 orëve nga marrja dijeni e rezultatit të provimit, i cili bën verifikimet e duhura dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës, vë menjëherë në dijeni dekanin. Dekani, brenda 48 orësh nga marrja dijeni për ankesën nga Përgjegjësi i Departamentit, ngre një komision Ad-hoc i cili bën verifikimin e pretendimeve të studentit. Me miratim të Dekanit, komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit.

Neni 12 Riprovimet

Studenti ka të drejtë të japë provim në tre sezone të rregullta: sezonin e verës, vjeshtës dhe dimrit.

Në raste të caktuara, mund të hapen edhe dy sezona të veçanta (tetor dhe prill).

Neni 13 Rishikimi i notës

Bazuar në nenin 54, të Rregullores së Universitetit të Tiranës.

- a) Studenti ka të drejtën e rishikimit të notës në çdo vit akademik, për deri në tre lëndë nga detyrimet e atij viti.
- b) Për rishikim note, studenti testohet vetëm njëherë për lëndën e zgjedhur dhe vetëm në sezonin e riprovimeve, duke mbetur në fuqi nota me të cilën studentin vlerësohet në fund.
- c) Studenti i vitit të fundit, ka të drejtë të rishikojë deri në 4 lëndë përfshirë këtu edhe lëndë nga vitet paraardhëse.
- d) Rishikimet e notës bëhen në sezonin e riprovimeve dhe për këtë studentin regjistrohet online në faqen eeb të fakultetit.
- e) Studenti ka të drejtë të kërkojë rishikimin e notës së një lënde jo më shumë se një herë.
- f) Nëse nota e rishikimit është 4 (katër), rregullat akademike për shlyerjen e detyrimeve nuk ndryshojnë.
- g) Në listën e notave që shoqërojnë diplomën do të pasqyrohen vetëm notat përfundimtare kaluese (5,6,7,8,9,10).

Neni 14 Kalimi në vitin pasardhës dhe në mbrojtjen e diplomës të programit studimor

- a) Studenti kalon nga viti i parë në vitin e dytë, kur ka siguruar të paktën 30 kredite të lëndëve në planin mësimor të vitit të parë. Kur kjo mundësi nuk përmbushet studentin në vitin pasardhës ndjek lëndët e mbetura të vitit të parë.

- b) Studenti kalon nga viti i dytë në vitin e tretë, kur ka siguruar të paktën 90 kredite të lëndëve në Planin mësimor nga viti i parë dhe i dytë. Kur kjo mundësi nuk përmbushet, studentin në vitin pasardhës ndjek lëndët e mbetura të vitit të parë ose të dytë.
- c) Studenti i vitit të fundit që në përfundim të provimeve të vitit rezulton me deri në 30 kredite të pashlyera, ka të drejtë t'i likuadojë ato përpara sezonit të diplomimit, në një periudhë të caktuar nga dekanati, në marrëveshje me njësinë përkatëse të programit të studimit. Studenti që shlyen këto detyrime, lejohet të hyjë në provimin përfundimtar të diplomës. Në rast të kundërt, i lind e drejta e shlyerjes së tyre në sezonin pasardhës të riprovimeve.
- d) Studenti lejohet të hyjë në mbrojtjen e diplomës, pasi ka fituar të gjitha kreditet e parashikuara në programin e studimit.

Neni 15 Diplomimi

Bazuar në nenet 59-62, të Rregullores së Universitetit të Tiranës.

- a) Përmbyllja e detyrimeve të programit të studimit Bachelor ne Histori bëhet me provim të përgjithshëm përfundimtar ose me punim diplome.
- b) Detyrimi përmbyllës i programit të studimit Bachelor ne Histori përllogaritet 6 kredite ECTS.
- c) Hartimi i programit (syllabusit) të provimit të formimit për programin e studimit, bëhet nga një komision *ad-hoc* i ngritur nga Departamenti ku marrin pjesë përfaqësues nga çdo Grup mësimor kërkimor i tij. Diskutimi i programit të provimit të formimit bëhet më pas nga Departamenti dhe miratohet nga Përgjegjësi Departamentit.
- d) Mbrojtja e diplomës bëhet në dy sezona: sezoni i verës dhe sezoni i vjeshtës. Afatet përcaktohen nga Dekani.
- e) Studenti që rrëzohet në sezonin e parë të mbrojtjes së diplomës, ka të drejtë të riparaqitet për mbrojtje në sezonin e ardhshëm.

Neni 16 Procedura e Diplomimit

- a) Në përfundim të kursit të plotë të studimeve “Bachelor” në “Histori”, studentët kanë të drejtë të diplomohen.
- b) Në përfundim të programit të studimeve të ciklit të parë, për fitimin e diplomës parashikohet një provim përfundimtar me shkrim ose punimi i një teme diplome.
- c) Shlyerja e detyrimeve të programit të studimit dhe çdo detyrimi tjetër financiar dhe material kundrejt universitetit, është kusht paraprak për zhvillimin e provimit përfundimtar dhe më tej fitimin e diplomës.
- d) Sekretaria mësimore pranë Dekanatit i përcjell Dekanin dhe ky i fundit Drejtuesit të Departamentit, listën e studentëve që kanë plotësuar detyrimet akademike dhe financiare të programit të studimit, si dhe që kanë të drejtën të futen në provimin e diplomës. Sekretaria mësimore mban përgjegjësi për saktësinë e të dhënave.
- e) Kryetari i Komisionit të provimit të diplomës i përcjell sekretarise së Fakultetit listën e studentëve me vleresimet përkatëse në provimin e diplomës, për të përgatitur diplomat përkatëse.

- f) Diplomimi bëhet në dy sezone: sezoni i verës dhe sezoni i vjeshtës. Afatet përcaktohen nga dekani. Kandidati diplomant, i cili rrëzohet në sezonin e parë të mbrojtjes së diplomës, ka të drejtë të riparaqitet për mbrojtje në sezonin e ardhshëm

Neni 17

Procedura e provimit të diplomës

- a) Bazuar në Rregulloren e Universitetit të Tiranës, provimi i diplomimit të studentëve të Ciklit të Parë të studimeve Bachelor në Histori zhvillohet me shkrim.
- b) Pyetjet për ciklin e parë të studimeve “Bachelor” në “Histori” do të jenë nga lëndët e kurrikulës.
- c) Pyetjet e zgjedhura nga të gjithë pedagogët që zhvillojnë lëndët pëkatëse (që zakonisht janë edhe anëtarët e komisionit *Ad-hoc*) i dorëzohen Kryetarit të Komisionit të provimit.
- d) Kryetari i Komisionit të Provimit në bashkëpunim me stafin akademik të grup-lëndëve të programit harton listën e temave të provimit të diplomës e cila u vihet në dispozicion studentëve të paktën 2 muaj para provimit të diplomimit.
- e) Tezat përgatiten 1 ditë para provimit nga Komisioni i Provimit dhe firmosen nga Drejtuesi i Departamentit të Historisë dhe anëtarët e Komisionit
- f) Komisioni i Provimit të Diplomës përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë.
- g) Cdo anëtar i komisionit jep vlerësimin përkatës për cdo student me pikë, dhe vlerësimi final me notë i studentit bazohet në pikët totale të marra prej tij.
- h) Të gjitha procedurat e tjera të diplomimit do të zhvillohen sipas rregulloreve të Universitetit të Tiranës dhe rregulloreve të Departamentit Historisë.

Neni 18

Pajisja me diplomë

Bazuar në nenin 63, të Rregulloreve të Universitetit të Tiranës:

- a) Studentët që kanë plotësuar detyrimet e një programi studimi dhe çdo detyrim tjetër financiar dhe material kundrejt universitetit pajisen me diplomë e cila është një dokument zyrtar.
- b) Diplomat e Programit të Ciklit të Parë të studimeve Bachelor në “Histori” shoqërohet me listën e Notave (në listën e notave që shoqërojnë diplomën pasqyrohen vetëm notat përfundimtare kaluese ≥ 5 të çdo lënde) dhe me suplementin e diplomës. Suplementi i Diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e hapësirës Europiane të arsimit të lartë. Ai përshkruan në veçanti, natyrën, nivelin, përmbajtjen, rezultatet e studimeve që janë kryer dhe përfunduar me sukses nga mbajtësi i diplomës.
- c) Përmbajtja dhe forma e diplomës është e përcaktuar në udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Diploma nënshkruhet prej Dekanit të Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë dhe Rektorit të Universitetit të Tiranës. Për secilin prej tyre shënohet emri, mbiemri, grada dhe titulli shkencor. Nënshkrimi i Rektorit shoqërohet me vulën e Universitetit të Tiranës.
- d) Për këtë program të ciklit të parë të studimeve lëshohet diploma: Diplomë Bachelor në “Histori”.

Neni 19

Tërheqja e diplomës

Bazuar në nenin 64-66, të Rregullores së Universitetit të Tiranës:

- a) Tërheqja e diplomës bëhet personalisht nga i diplomuari, kundrejt nënshkrimit dhe evidentohet në regjistrin përkatës.
- b) Nëse prania e të diplomuarit është objektivisht e pamundur, tërheqjen e diplomës mund t'a bëjë një nga pjesëtarët e familjes, i pajisur me prokurë të posaçme e cila bashkëngjitet në regjistrin e tërheqjes së diplomave, duke paraqitur dhe një dokument identifikimi të tij.
- c) Nëse diploma nuk është plotësuar në rregull, i interesuari duhet të mos e tërheq atë dhe të kërkojë pajisjen me diplomë të rregullt. Nëse i interesuari e tërheq diplomën e parregullt, në rast se i humbet origjinali ose i dëmtohet duke iu bërë i papërdorshëm, universiteti nuk lëshon dublikatë. Lejohet vetëm dhënia e listës së notave të fituara dhe vërtetim me fotografi i cili është ekuivalent me diplomën, pasi nënshkruhet nga Rektori i Universitetit, Dekani dhe kryesekretari. Nënshkrimet e tyre vërtetohen me vulën e Universitetit të Tiranës. Diploma e plotësuar në mënyrë të parregullt, asgjësohet me një komision të përbërë prej tre anëtarësh të caktuar me urdhër të Dekanit me hartimin e procesverbalit përkatës, i cili depozitohet në sekretarinë mësimore, përpara se i interesuari të pajiset me vërtetim me fotografi ekuivalent me diplomën.
- d) Nëse një shtetas i diplomuar në Universitetin e Tiranës rezulton me dy dokumente diplomimi, diplomë origjinale dhe vërtetim me fotografi ekuivalent me diplomën, do të quhet i vlefshëm dokumenti i lëshuar në datën më të vonë.
- e) Në Universitetin e Tiranës, dorëzimi i diplomave bëhet me ceremoni në të cilën marrin pjesë autoritete drejtuese të fakultetit/institutit dhe të Rektoratit. Për studentët që kanë përfunduar studimet me të gjitha notat dhjeta, jepet Çertifikata “Medalje e Artë”. Për studentët që gjatë studimeve, kanë marrë mbi 80% të notave 10 (dhjeta) dhe pjesën tjetër vetëm 9 (nënta), jepet Çertifikata “Student i Shkëlqyer”.

KREU IV TË DREJTAT DHE DETYRIMET E STUDENTËVE

Neni 20 Të drejtat e studentëve

Të drejtat dhe detyrat e studentëve janë të parashikuara në nenin 84-85 të Rregullores së UT, 2014, ndërsa shkeljet disiplinore nga studentët parashikohen në nenin 89-91 të po kësaj rregulloreje.

Studenti ka të drejtë:

- a. Të ndjekë leksione, seminare dhe të gjitha veprimtaritë e tjera mësimore, të organizuara në përputhje me statusin e tij.
- b. Të përdorë pajisjet, bazën materiale dhe laboratorike të universitetit sipas rregullave përkatëse, për të realizuar programin mësimor dhe punën e programuar në aktivitetin e tij shkencor, bibliotekën dhe mjediset sportive e kulturore të universitetit.
- c. Të zgjedhë dhe të zgjidhet në organet drejtuese, si në Senatin Akademik, në Këshillin e Administrimit të UT, në Këshillat e Fakulteteve ku janë të regjistruar, në përputhje me ligjin për arsimin e lartë dhe Statutin e Universitetit.

- d. Të organizohet në shoqata të ndryshme jopolitike në përputhje me aktet ligjore e nënligjore përkatëse.
- e. Të përfitojë bursë studimi brenda ose jashtë shtetit kur plotëson kushtet e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, Senatit e në marrëveshjet ndërshtetërore ose ndëruniversitare.
- f. Të përfitojë shpërblime të veçanta që akordohen nga Universiteti i Tiranës sipas ligjit dhe kritereve të caktuara nga Senati Akademik.
- g. Të shprehë opinionin e tij për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të universitetit
- h. Të ankohet për shkelje të rregullave dhe standarteve akademike nga ana e pedagoqeve, mosrealizimin e procesit të mësimdhënies, rregullat për zhvillimin e provimit dhe për vlerësimin e tij të pa merituar.
- i. Të ankohet për shkelje të etikës akademike, të konfliktit të interesit dhe të çdo rasti tjetër që çënon integritetin e studentit.
- j. Të ndjekë studimet në një degë të dytë, në sistem të ndryshëm nga ai që ndjek, sipas përcaktimeve në këtë rregullore, në vendimet e Senatit apo në aktet e posaçme të Ministrisë së Arsimit dhe të Sportit.
- k. Të marrë pjesë në plotësimin e pyetësorëve të organizuar nga Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës për cilësinë e mësimdhënies për lëndët në fund të çdo semestri.

Të drejta të tjera të studenteve janë përcaktuar në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Statutin (2018) dhe në Rregulloren (2015) të UT.

Neni 21

Detyrimet e studentëve

Studenti është i detyruar:

- a. Të njohë me hollësi Statutin, Rregulloren e Universitetit dhe çdo Rregullore tjetër e detyrimet që lindin prej tyre, si dhe të jetë i vetëdijshëm për zbatimin e tyre. Në të kundërt, Universiteti nuk mban përgjegjësi për pasojat që mund të rrjedhin nga mosnjohja e tyre.
- b. Të njohë të gjithë kërkesat e përgjithshme të universitetit, si dhe kërkesat specifike të programit në fushën që ata kanë zgjedhur.
- c. Të respektojë Kodin e Etikës së universitetit.
- d. Të shlyejë detyrimet e përcaktuara në programin e studimit si dhe çdo detyrim tjetër financiar dhe material ndaj universitetit.
- e. Të mbajë përgjegjësi për shkeljet e rregullave të universitetit nga ana e tij; dëmet materiale që ai mund të ketë shkaktuar zhdëmtohen në masën e përlogaritur.

Detyra apo përgjegjësi të tjera të studentëve janë përcaktuar në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Statutin (2018) dhe në Rregulloren (2015) të UT.

Neni 22

Përgjegjësi të tjera të studentëve

Përgjegjësitë e studentit përfshijnë ndër të tjera edhe pikat më poshtë:

- a. Studenti duhet të njohë dhe të respektojë rregullat e zhvillimit të orës së mësimi të përcaktuara në syllabus dhe të komunikuar në auditor nga pedagogu.
- b. Studenti duhet t'i drejtojë ankesat në lidhje me zhvillimin e procesit mësimor tek autoritetet drejtuese.
- c. Studenti duhet të respektojë oraret e konsultimeve të komunikuar nga pedagogu.

Neni 23

Masat disiplinore për studentët

Shkelje e rregulloreve të universitetit konsiderohen të gjitha veprimet e kryera nga ana e studentit që çenojnë personalitetin e personelit akademik, të çdo punonjësi tjetër të universitetit dhe cdo studentit, normat etiko-morale të shoqërisë si kopjimi në provime, falsifikimi i dokumentave të ndryshme, fyerjet, sharjet, aktet e rrugaçërisë, të vjedhjes etj., kur këto veprime nuk bartin elementë të veprës penale. Ndaj studentit që kryen këto veprime, merren këto masa disiplinore:

1. Këshillim me shkrim;
2. Vërejtje me shkrim;
3. Pezullim nga shkolla për atë vit akademik;
4. Çregjistrim nga Universiteti i Tiranës.

Masat disiplinore “vërejtje me shkrim”, “pezullim nga shkolla për vitin akademik” dhe “çregjistrimi nga UT” bëhet me vendim të dekanit. Kundër vendimit të dekanit për çregjistrim, studentit ka të drejtë të ankohet tek Rektori. Kundër vendimit të Rektorit për çregjistrim, studentit mund të ankohet në gjykatë. Masat disiplinore pasqyrohen në regjistrin e studentëve. Studenti konsiderohet i rehabilituar, nëse nuk bën shkelje tjetër me kalimin e një muaji për këshillimin, brenda tre muajve për vërejtjen dhe një viti për pezullimin.

KREU V

KOMUNIKIMI

Neni 24

Rregullat e sjelljes akademike

Të gjithë anëtarët e komunitetit akademik në Universitetin e Tiranës duhet të praktikojnë dhe të ruajnë standartet e integritetit akademik dhe ndershmërisë. Integritet akademik do të thotë të paraqesësh vetveten dhe punën tënde me ndershmëri. Më poshtë janë disa shembuj pandershmërie akademike:

- a. Mashtrim në provime. Këtu përfshihet: përdorimi i materialeve si libra dhe/ose shënime në formë të printuar apo elektronike kur një gjë e tillë nuk është e autorizuar nga pedagogu,

kopjimi nga testimi apo detyra e dikujt tjetër, lejimi i dikujt tjetër për të kopjuar punën tënde, zëvendësimi i punës tënde me punën e dikujt tjetër, ose të tjera forma shkeljesh në sjellje gjatë provimeve.

- b. Plagjiaturë e punës së të tjerëve. Plagjiaturë do të thotë të përdorësh punën ose idetë e dikujt tjetër duke i konsideruar ato të veta.
- c. Falsifikimi i dokumentave apo paraqitja dizinformuese e kredencialeve të një personi është shkelje.

Pedagogët duhet të respektojnë standartet e mëposhtme në kontekstin e sjelljes akademike:

- a. Të informojnë dhe të udhëzojnë studentët mbi procedurat dhe standartet e punës kërkimore, si dhe mbi dokumentacionin e kërkuar për të kryer detyra në një kurs të caktuar apo në kontekstin e një disipline të caktuar.
- b. Të ndërmarrin hapa konkretë për të dalluar dhe parandaluar mashtrimin.
- c. Të raportojnë sjelljen akademike të dyshuar jo etike tek dekani.
- d. Të paraqesin evidencë të plagjiaturës, të mashtrimit në provime apo raporte laboratorit, të falsifikimeve të dokumentave apo të tjera forma sjelljeje të pandershme akademike në autoritetet drejtuese përkatëse.

Studentët duhet të respektojnë standartet e mëposhtme në kontekstin e sjelljes akademike:

- a. Të jenë në dijeni të praktikave dhe standardeve të shkollimit të ndershëm.
- b. Të ndjekin udhëzimet e pedagogëve në lidhje me provimet dhe detyrat në mënyrë që të evitojnë një paraqitje të keqe të punës.
- c. Të jenë të sigurt që rregulla të veçanta në lidhje me dokumentimin e detyrave të kursit, të procedurave të provimit, të përdorimit të informacioneve e programeve kompjuterike, etj., janë kuptuar qartë.
- d. Nëse studentët janë të bindur që praktikat e përdorura nga pedagogu janë të favorshme ndaj mashtrimit, ata mund t'ia përcjellin këtë mesazh Përgjegjësitet të Departamentit të Historisë, Dekanit ose t'i drejtohen me ankese të drejtëpërdrejtë Rektorit. Raste të tilla do të gjykohen dhe vlerësohen sipas rregulloreve në fuqi.

Neni 25

Normat etike gjatë komunikimit Personel Akademik – Student

Gjatë veprimtarisë së mësimdhënies shpesh vihen re problematika rreth koordinimit të punës së stafit me studentët. Për këtë qëllim kjo Rregullore sugjeron të ndiqen disa udhëzime praktike të miratuara si më poshtë:

- a) Studenti është i detyruar të zbatojë e respektojë Kodin e Etikës të miratuar në UT.
- b) Kontakti i pedagogut me studentin për aspekte të mësimdhënies apo kërkimit shkencor do të bëhet vetëm në ambientet e auditoreve, laboratoreve dhe në asnjë rast jashtë tij.
- c) Komunikimi me studentin mund të bëhet në rrugë elektronike në adresën e pedagogut e cila është regjistruar më parë në departament.
- d) Justifikimet nga ana e studentëve tek pedagogu për mungesat gjatë vitit pranohen vetëm pas dorëzimit të raporteve të marrë nga komisione të posacëm.

- e) Në rast të vonësave të pedagogut në auditor studenti duhet të presë disa minuta dhe nëse pedagogu nuk ka njoftuar paraprakisht ai mund të largohet.
- f) Në auditor, laboratorë si dhe gjatë provimit nuk lejohet përdorimi i mjeteve të komunikimit.
- g) Në ditën e provimit studenti respekton me përpikmëri datën, vendin (sallën) e provimit, si dhe siguron mjetet e nevojshme (stilolaps, makinë llogaritëse, mjet identifikimi).
- h) Në ambjentet e provimit nuk lejohet prania e familjarëve të studentit përveçse personave të autorizuar nga ana e Përgjegjës të Departamentit (pedagogë, sekretare).
- i) Pedagogu ju'a komunikon notën studentëve duke respektuar konfidencialitetin (në mungesë të sistemit) ose bën verifikime të vlerësimit në një orar e sallë të caktuar.

Neni 26

Çështje akademike

Çdo njësi akademike duhet te respektojë procedurat për zgjidhjen e ankesave, në lidhje me vlerësimin, standartin dhe cilësinë e mësimdhënies, situatat brenda në auditor dhe cdo problem tjetër akademik. Për rastet e ankesave në lidhje me vlerësimin, ndiqet ajo procedurë e përcaktuar në nenin 50 të rregullores së UT.

Neni 27

Çështje jo akademike

Personeli i universitetit dhe studentët mund të hasin situata problematike gjatë kohës së punës apo të studimeve në Universitetin e Tiranës në të cilat mund të përfshihen rastet e fyerjeve, sharjeve, konfrontimeve fizike. Qëndrimi diskriminues apo ngacmimi seksual, sharjet apo fyerjet raciste, sharjet për orientimin seksual, për ngjyrën, fenë, bindjet, origjinën kombëtare apo prejardhjen, gjendjen martesore, gjendjen familjare etj., kërkojnë vëmendje të veçantë në zgjidhjen e tyre.

KREU VI

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 28

Rishikimi dhe përditesimi

Çdo çështje që lind nga zbatimi i kësaj rregulloreje dhe nuk mbulohet prej saj, rregullohet me Rregulloren e Brendshme të Universitetit. Në rast se edhe kjo e fundit nuk e mbulon, atëherë Departamenti i Historisë i propozon Dekanit ndryshimet e nevojshme për miratim.

Përgjegjësi i departamentit të historisë

Prof. Dr. Valentina Duka